



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 14.7.2020

### R A P O R T

#### **PËR DEKRETIN NR. 11518, DATË 22.6.2020, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 66/2020 “PËR TREGJET FINANCIARE TË BAZUARA NË TEKNOLOGJINË E REGJISTRAVE TË SHPËRNDARË”**

#### **I. HYRJE.**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 14 korrik 2020, shqyrtoi dekretin nr.11518, datë 22.6.2020, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”. Ky dekret është propozuar në mbështetje të neneve 85 pika 1 dhe 93 të Kushtetutës. Dekreti u shqyrtua në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenet 32-38 dhe 86 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relator, për këtë dekret, z. Anastas Angjeli.

Mbështetur në nenin 86 të Rregullores së Kuvendit, dekreti u shqyrtua vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetimin për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës. Shqyrtimi i dekretit në Komisionin për Ekonominë dhe Financat dhe dorëzimi i raportit të këtij Komisioni u bënë brenda 4 javëve nga data e depozitimit të tij në Kuvend (dekreti është depozituar në Kuvend në datën 23 qershor 2020 dhe afati për dorëzimin e raportit të komisionit është brenda datës 21 korrik 2020).

Në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm, për të dhënë mendime mbi dekretin dhe informacione të kërkuara nga deputetët:

Nga Presidenca:

- Z. Bledar Dervishaj, Këshilltar i Presidentit për Çështjet Ligjore;
- Znj. Katrin Treska, Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike në Institucionin e Presidentit të Republikës.

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Znj. Adela Xhemali, Zëvendësministre;
- Z. Saimir Muçmataj, Drejtor Juridik.

Nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare:

- Znj. Violanda Theodhori, Drejtoreshë e Departamentit të Çështjeve Ligjore;
- Z. Niko Kotonika, Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve dhe Kapitaleve.

Për të pasur një mendim sa më profesional për çështjet e parashtruara në dekret, Komisioni mori mendimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si institucione që kanë kontribuar në hartimin e projektligjit dhe kanë bashkëpunuar ngushtë me Komisionin për Ekonominë dhe Financat gjatë shqyrtimit të tij në Kuvend.

Ligji nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë” është miratuar si pjesë e paketës ligjore, në të cilën bëjnë pjesë edhe:

- Ligji nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”;
- Ligji nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”;
- Ligji nr. nr.62/2020 “Për tregjet e kapitalit”.

Ashtu si ligjin nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, Presidenti i Republikës ka kthyer për rishqyrtim në Kuvend edhe ligjin nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave” dhe ligjin nr.62/2020 “Për tregjet e kapitalit”, dekrete të cilat janë rrëzuar nga Kuvendi.

## **II. BAZA LIGJORE PËR SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

### **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:**

Neni 85

1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.
2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

### **Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë:**

Neni 86

Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji

1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht. Dekreti i Presidentit për rishqyrtim ligji futet automatikisht në programin e punës së Kuvendit.
2. Dekreti për kthimin e ligjit për rishqyrtim bëhet pjesë e rendit të ditës të mbledhjes më të parë.

3. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetimin për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës.
4. Komisioni përgjegjës përgatit raportin për seancën plenare me propozimin për pranimin ose rrëzimin e dekretit të Presidentit brenda 4 javëve nga data e depozitimit të tij në Kuvend. Në rastin e pranimit të dekretit, raporti përmban formulimet për nene të veçanta të ligjit.
5. Dekreti për kthim për rishqyrtim të ligjit bëhet pjesë e rendit të ditës të seancës plenare, por jo më parë se 48 orë.
6. Seanca plenare e shqyrton dekretin për kthim për rishqyrtim të ligjit vetëm për arsytet e kthimit të tij.
7. Kuvendi në seancë plenare voton me shumicën e kërkuar në Kushtetutë për pranimin ose rrëzimin e dekretit.
8. Në rast pranimi të dekretit, Kuvendi voton në parim propozimet që komisioni përgjegjës ka paraqitur në raport. Kuvendi voton vetëm nenet që reflektojnë propozimet e miratuara në komision, si dhe bëhet votimi në tërësi për ligjin.
9. Ligji i votuar në tërësi mban numrin që ka marrë me miratimin e parë, kurse data do të jetë e votimit më të fundit në tërësi.

### **III. ARSYET PËR KTHIMIN PËR RISHQYRTIM TË LIGJIT SIPAS DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS.**

#### **III.1. ARSYETIMI I PËRGJITHSHËM PËR KTHIMIN PËR RISHQYRTIM TË LIGJIT.**

Dekreti nr.11518, datë 22.6.2020, i Presidentit të Republikës, shoqërohet me arsyetimin për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistruar të shpërndarë”.

Në arsyetimin për kthimin e ligjit Presidenti i Republikës i referohet objektit të ligjit, që është:

*a) rregullimi i emetimit të tokenëve digjitalë dhe/ose të monedhave virtuale;*

*b) licencimi, monitorimi dhe mbikëqyrja e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e:*

- i) shpërndarjes, tregtimit e ruajtjes së tokenëve digjitalë dhe/ose monedhave virtuale;*
- ii) agjentit të tokenëve digjitalë;*
- iii) ofruesit të shërbimeve inovative; dhe*
- iv) sipërmarrjes së automatizuar të investimeve kolektive.*

Gjithashtu, arsyetimi i dekretit i referohet argumenteve të dhëna në relacionin e projektligjit, ku theksohet se “*emetimi i rregulluar sipas ligjit të tokenëve digjitalë dhe monedhave virtuale dhe i tokenëve digjitalë të titujve krijojnë premisa për sigurimin e një burimi alternativ financimi për hapjen e bizneseve të reja dhe bizneseve të tjera inovative që do ta kishin të vështirë ose të kushtueshme për të mbledhur kapital përmes kanaleve tradicionale të financimit*”.

Më tej, arsyetimi i dekretit i referohet ligjeve të tjera të paketës ligjore, duke theksuar se ligji nr.55/2020 “Për shërbimet e pagesave” dhe ligji nr. nr.62/2020 “Për tregjet e kapitalit” janë kthyer për rishqyrtim, pasi për shkak të fushës së veçantë që trajtojnë, nuk parashikojnë qartë

procedurën e licencimit dhe mekanizmat e kontrollit efektiv dhe objektiv nga autoritetet mbikëqyrëse.

Ndërsa ligji nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, krahasimisht me dy ligjet e sipërcituara, është një ligj që paraqitet i mirëstrukturuar dhe përmban procedura më të detajuara për ushtrimin e veprimtarisë së rregulluar prej tij.

Teknologjia e regjistrave të shpërndarë ka mundësuar kryerjen e transaksioneve ekonomike ndërmjet dy palëve në distancë, pa përfshirjen e ndërmjetësuesve ose rregullatorëve. Ndërsa monedha virtuale është e mirëpritur në shumë pjesë të botës, disa vende janë të kujdesshme për shkak të:

- paqëndrueshmërisë;
- natyrës së decentralizuar;
- kërcënimit të perceptuar ndaj sistemeve monetare aktuale dhe
- lidhjeve me veprimtari të paligjshme si trafiku i drogës dhe pastrimi i parave.

Në arsyetimin e dekretit theksohet se ligji nr.66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë” cenon parimet kushtetuese të:

- sigurisë juridike;
- lirisë së veprimtarisë ekonomike, të përcaktuar në nenin 11 të Kushtetutës;
- barazisë para ligjit, të përcaktuar në nenin 18 të Kushtetutës;
- respektimit të shumicës së cilësuar për miratimin e ligjeve, të parashikuar në nenin 81 pika 2 të Kushtetutës;
- hierarkisë së akteve, të përcaktuar në nenin 116 të Kushtetutës;
- delegimeve për rregullimin e çështjeve me akte nënligjore, të përcaktuar në nenin 118 pika 2 të Kushtetutës.

Gjatë spjegimit të arsyeve për kthimin e ligjit, theksohet se 22 nene janë me problematika e konkretisht nenet 3, 9, 10, 13, 14, 15, 29, 36, 44, 45, 49, 51, 63, 70, 77, 82, 83, 88, 90, 92, 100, 105 të ligjit duhet të mbahen në konsideratë nga Kuvendi gjatë rishqyrtimit të këtij ligji.

Në arsyetimin e dekretit paraqiten 3 argumente kryesore për kthimin për rishqyrtim të ligjit, të cilat janë si më poshtë:

**Argumenti 1.** Rregullimi i emetimit të tokenëve digjitalë dhe/ose të monedhave virtuale, edhe pse është një risi teknologjike që përmban anë pozitive, në kushtet aktuale, për shkak të mungesës së plotësimin të kushteve dhe standardeve që kërkojnë tregje të tilla të regjistrave të shpërndarë, mund të jetë një proces i parakohshëm për t’u miratuar e zbatuar.

**Argumenti 2.** Zbatimi i këtij ligji në kushtet aktuale të vendit tonë, shoqërohet me rreziqet e transaksioneve ilegale të pastrimit të parave dhe të shmangjes fiskale.

**Argumenti 3.** Disa dispozita të ligjit paraqesin problematika.

Këto argumente detajohen me tej në pjesën III, ku pasqyrohen edhe mendimet lidhur me to.

## **III.2. ARSYETIMI I DETAJUAR PËR KTHIMIN PËR RISHQYRTIM TË LIGJIT.**

Në arsyetimin e dekretit pasqyrohen çështjet dhe argumentet e detajuara, në të cilat bazohet kërkesa për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr.66/2020, si më poshtë:

**Argumenti I. Rregullimi i emetimit të tokenëve digjitalë dhe/ose të monedhave virtuale edhe pse është një risi teknologjike që përmban anë pozitive, në kushtet akutale, për shkak të mungesës së plotësisimit të kushteve dhe standardeve që kërkojnë tregje të tilla të regjistruara të shpërndarë, mund të jetë një proces i parakohshëm për t'u miratuar e zbatuar.**

Sipas dekretit, ky argument mbështetet në:

*Së pari*, gjendjen aktuale në Shqipëri, ku përdorimi i tokenëve digjitale apo monedhave virtuale mund të shoqërohet me rreziqe dhe anë negative të ndryshme. Ky arsyetim mbështetet në disa argumente, si më poshtë:

**Argumenti 1.1.** Vlerësohet të ketë pak ose aspak mundësi mbikëqyrjeje nga rregullatori kur situata del nga kontrolli (ky aspekt, duke marrë në konsideratë dhe parashikimet e disa dispozitave të ligjit, bëhet edhe më problematik).

**Argumenti 1.2.** Vlera e tokenëve digjitalë dhe/ose të monedhave virtuale luhetet në mënyrë drastike dhe përdorimi i monedhës varet kryesisht nga disponueshmëria e internetit.

**Argumenti 1.3.** Shpejtësia e transaksionit dhe tarifat kanë tendencë të ndryshojnë në varësi të efikasitetit të punës për krijimin e tyre (minierave) dhe bllokimeve të rrjetit.

**Argumenti 1.4.** Shndërrimi i tokenëve digjitalë dhe/ose të monedhave virtuale në monedhë likuide është i kushtueshëm;

**Argumenti 1.5.** Nuk është i pranueshëm për çdo ofrues mallrash ose shërbimesh.

**Argumenti 1.6.** Struktura e “blockchain” do të thotë që çdo transaksion është përfundimtar dhe transaksionet janë të pandryshueshme.

**Argumenti 1.7.** Nëse bie viktimë e një mashtrimi ose bëhet një blerje aksidentale, nuk ka asnjë mënyrë që ky transaksion të anulohet.

**Argumenti 1.8.** Shumë çelësa privatë (kode) të tokenëve digjitalë dhe/ose të monedhave virtuale kanë humbur, duke kontribuar kështu në deflacionin dhe mbivlerësimin e vlerës së tyre.

**Argumenti 1.9.** Ndërfaqja e përdoruesit në shumicën e aplikacioneve DLT është ende e paqëndrueshme dhe rrjeti nuk është gati për t'u shërbyer të gjithëve në botë.

**Argumenti 1.10.** Sigurimi i tokenëve digjitalë dhe/ose të monedhave virtuale kërkon njohuri dhe vetëdije bazë të sigurisë në internet, ndërsa nuk jepet asnjë e dhënë mbi kapacitetin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për të mbuluar dhe monitoruar këtë fushë që nuk lidhet vetëm me dhënien e licencave, por mbi të gjitha kërkon mekanizma të aftë kontrolli.

**Argumenti 1.10.** Parimi i përdorimit të tokenëve digjitalë dhe/ose të monedhave virtuale shkon kundër institucioneve qeverisëse, politikës, bankave, rregullatorëve dhe kontrollit, e ka të ngjarë të ndeshet me shumë rezistencë përpara se këta aktorë ta tolerojnë ose aprovojnë atë.

**Së dyti,** për ligjin nr.66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë” qendrojnë të njëjtat argumente të dhëna në dekretin për kthimin e ligjit nr. nr.62/2020 “Për tregjet e kapitalit” se në tregun aktual financiar në Shqipëri, problematikë mbetet ende mes të tjerash edhe:

- Madhësia e vogël e ndërmarrjeve, me sisteme të dobëta të qeverisjes korporative;
- Institucione të dobëta qeverisëse legale, rregullatore dhe korporative për të mbrojtur investitorët.

Ndaj, edhe në këtë rast, është momenti që të reflektohet mbi faktin se zhvillimi i tregjeve financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë kërkon patjetër plotësimin e parakushteve, në mënyrë të veçantë:

- adresimin e standardeve të dobëta të qeverisjes së korporatave, dhe
- forcimin e kapaciteteve të institucioneve shtetërore mbikëqyrëse të këtyre tregjeve, për të përballuar në kohë rrezikun që mund të shfaqet.

Kjo është e nevojshme për të rritur nivelin e sigurisë së produkteve financiare dhe të vetë stabilitetit ekonomiko-financiar, në mbrojtje të interesit publik.

**Argumenti 2. Zbatimi i këtij ligji, në kushtet aktuale të vendit tonë, shoqërohet me rreziqet e transaksioneve ilegale të pastrimit të parave dhe të shmangjes fiskale.**

Në arsyetimin e dekretit për këtë çështje theksohet se:

1. Të dhënat publike tregojnë se, në të gjitha vendet, ka patur një shqetësim mbi rastet e shumta të mashtrimit nëpërmjet emetimit dhe tregtimit të tokenëve digjitalë dhe/ose monedhave virtuale. Ndaj dhe, siç citohet në relacionin shoqëruar të nismës: *“Shumica e vendeve të tjera janë duke aplikuar të ashtuquajturat “regulatory sandboxes”, që përfaqësojnë një ambient testimi, ku autoriteti kompetent përkatës teston tregun, duke lëshuar licenca me afat të shkurtër, ku vlerësohen të gjitha rreziqet e problematikave që has tregu përpara se të hartohet një ligj kombëtar, ndërkohë që nuk frenon bizneset inovative të shfrytëzojnë idetë e tyre. Aktualisht, megjithëse në Evropë ky fenomen “regulatory sandboxes” është kthyer në një trend, në Shqipëri nuk suportohet nga ligjet bazë të autoriteteve kompetente; pra, këto autoritete nuk kanë të drejtë të lëshojnë rregullore me qëllimin e testimit të tregut, si dhe identifikimit të problematikave. Duke u nisur nga sa më sipër, është e rëndësishme që Shqipëria të përgatitë kornizën ligjore në lidhje me aktivet virtuale.”*

2. Ky qëndrim i shprehur dhe në relacion, përveçse reflekton qartë shqetësimin që bartin në vetvete tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë dhe ngurimin për aplikim në shumicën e vendeve, është kundërtënes me vetë ndërmarrjen e kësaj nisme në këto momente, pa një analizë të mirëfilltë të gatishmërisë së Shqipërisë për implementimin e këtyre tregjeve.

3. Disa vende kanë ndaluar plotësisht monedhën digjitale, ndërsa të tjera vende janë përpjekur të ndërpresin çdo mbështetje nga sistemi bankar dhe financiar thelbësor për tregtimin dhe përdorimin e tij. Natyra e decentralizuar dhe anonime e monedhës virtuale ka sfiduar shumë qeveri mbi mënyrën se si të lejojnë përdorimin e ligjshëm duke parandaluar transaksionet kriminale. Shumë vende ende janë duke analizuar mënyra për rregullimin e monedhës virtuale.

Miratimi i ligjeve në këtë fushë mbetet ende një risi dhe për vendet e zhvilluara, ndërsa në Shqipëri, ndërmerren direkt hapa për implementimin e tyre pa një vlerësim të mirëfilltë, vlerësim ky që mungon në praktikën dokumentare parlamentare. Implementimi i dispozitave të tilla ligjore, në një realitet si ky i yni, bart me vete rrezikun e shumëfishimit të rreziqeve negative që kjo risi paraqet në vende të zhvilluara. Këto rreziqe mund të sjellin pasoja sociale brenda familjeve shqiptare dhe pasoja ekonomike, deri në atë masë sa mund të lëkundin stabilitetin e monedhës vendase, rritjen e inflacionit apo të kursit të këmbimit të lekut me monedha të huaja.

4. Pastrimi i parave dhe veprimtaria terroriste janë dy nga shqetësimet më të mëdha që lidhen me monedhën virtuale, sepse implikimi i veprimtarisë kriminale dhe transaksionet e tyre nuk mund të gjurmohen nga qeveria. Në ligjin e paraqitur si dhe në relacionin shoqërues, gjithsesi nuk i është kushtuar rëndësi shpjegimit të parandalimit të lidhjes së mëposhtme:

- Veprimtari kriminale; Transaksione të paligjshme; Pastrim parash; dhe Evazion fiskal.

Miratimi i kuadrit ligjor dhe fillimi i menjëhershëm i zbatimit të tij, pa përgatitjen e duhur të organeve monitoruese dhe mbikëqyrëse, bart rrezikun evident të krijimit të hapësirave për përdorimin e tregjeve financiare të tilla edhe nga krimi, pa mundësi efektive parandalimi, gjurmimi dhe ndëshkimi. Nëse një situatë e tillë ndodh, atëherë dëmi për sistemin financiar në tërësi, investimet e individëve në veçanti, por dhe për procesin e integritetit evropian të vendit, do të ishte shumë i madh.

Ndaj është detyrim i Kuvendit t'i vlerësojë këto rreziqe për të rishikuar gjithashtu edhe momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pasi periudha e parashikuar për 1 shtator 2020 është shumë e shkurtër dhe përfshin periudhën në të cilën vendi ynë ende vijon të jetë nën efektet e forta të dy goditjeve nga fatkeqësitë natyrore. Gjithashtu, u duhet lënë koha e nevojshme edhe autoriteteve licencuese dhe kontrolluese për të njohur ligjin, për të hartuar kuadrin sa më efikas nënligjor, si dhe për të rivlerësuar nëse disponojnë mekanizma apo burime njerëzore të mbikëqyrjes së këtyre veprimtarive risi për vendin tonë.

5. Ky rrezik është veçanërisht më i madh, kur edhe sa i përket pjesëmarrjes influencuese (të drejtpërdrejtë ose të tërthortë) në kapitalin e një personi juridik, është përcaktuar pa asnjë sqarim nivel i zotërimit të kapitalit ose të drejtave të votës në masën mbi 10% (neni 3, pika 11 dhe 36 e ligjit), ndërkohë që në zhvillimin e aktiviteteve të tilla, rëndësi thelbësore merr identifikimi i të gjithë zotëruesve të kapitalit apo të aksioneve, pavarësisht përqindjes së deklaruar.

Ndaj një nismë e tillë, e miratuar pa një vlerësim të thelluar të kushteve ekonomike dhe rregullatore të vendit, që nuk synon të përafrojë asnjë rregullore apo direktivë, rrezikon të cenojë interesin publik në tërësi, për shkak se prek shumë aspekte të jetës dhe veprimtarisë së përditshme.

### **ARGUMENTI 3. DISA DISPOZITA TË LIGJIT DHE SHPJEGIMET E DHËNA NË RELACIONIN SHOQËRUES PARAQESIN PROBLEMATIKA.**

Sipas arsyetimit të dekretit, dispozitat që paraqesin problematika janë si më poshtë:

1. Ligji parashikon dhe tregtimin e tokenëve digjitalë të aseteve, kur që në dispozitën e përkufizimeve në nenin 3, pika 21, jep dhe përkufizimin e tij përmes metodës përjashtimore, citojmë: ““Tokeni digjital i aseteve” është çdo token digjital, i cili nuk përfshihet në asnjë prej kategorive të mëposhtme:

- i. token digjital i pagesave;
- ii. token digjital i titujve;
- iii.token digjital shërbimesh”.

Ndërsa në pikën 27 të po këtij neni, përcaktohet se në Bursën DLT, mund të listohen e tregtohen tokenë digjitalë të shërbimeve, tokenë digjitalë të pagesave dhe tokenë digjitalë të aseteve.

Kuptimi i “asetit” sipas kuadrit ligjor në fuqi, lidhet me pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme.

Ndaj dhe ky rregullim, përfshirë dhe tokenin digjital të titujve, qartazi njeh mundësinë që aksione shoqërisht tregtare, pasuri të luajtshme por edhe të paluajtshme, apo pjesë të tyre, për nevoja likuiditeti, të tregtohen në bursë përmes tokenëve digjitalë.

Ky rregullim ndërkohë, edhe pse është një nga mënyrat e reja më të përhapura të qarkullimit financiar, nuk merr aspak në konsideratë kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sa i takon mënyrës së transferimit dhe regjistrimit të pronësisë, për ilustrim, të aksioneve të një shoqërie tregtare apo të pasurive të paluajtshme. Ndaj dhe zbatimi i këtij ligji për këto kategori titujsh, pa një analizë të gjithanshme të kuadrit ligjor të zbatueshëm që mund të kërkonte amendime, mbetet thujse i pazbatueshëm, duke krijuar një pasiguri të madhe juridike për personat që mund të hyjnë në këto lloj transaksionesh.

Për më tepër, kjo mungesë e harmonizimit është edhe më e rëndë, kur vetë koncepti i tregtimit me monedha virtuale, nënkupton tregtim pa kufij fizikë mes vendeve, ndërkohë që kur bëhet fjalë për asetet e paluajtshme, legjislacioni në fuqi, në varësi të llojit të pasurisë së paluajtshme, përmban dhe kufizime sa i përket transferimit të pronësisë të shtetasit e huaj.

2. Ligji, duke nisur që nga neni 3, pika 36, sa i përket vlerësimit të kërkuesve për pajisje me licencë, referon në legjislacionin në fuqi për tregjet e kapitalit për kuptimin e termit “i aftë dhe i përshtatshëm”. Edhe për koncepte të tjera, ky ligj referon në kuptimet që jep ligji për tregjet e kapitalit, ligj që gjithashtu është kthyer për rishqyrtim në Kuvend dhe që paraqet problematika mbi të cilat ligjvënësi duhet të reflektojë.

Ndërkohë, sa i përket nenit 9 të ligjit:

- vlerësimi i reputacionit profesional e personal, përvojës, burimeve të mjaftueshme financiare, aftësisë dhe përshtatshmërisë, si kritere për licencimin e subjekteve kërkuese; dhe
- mungesa e delegimit të mirëfilltë për rregullimin e çështjeve të caktuara sipas kërkesave të nenit 118 të Kushtetutës, pa përcaktuar qartë as llojin e aktit (pika 2 dhe 3 e nenit),



lënë hapësira të mëdha diskrecionale për autoritetet, duke krijuar premisa për abuzime gjatë zbatimit në praktikë, e për pasojë, çojnë në cenim të lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe të aksesit në këtë fushë.

**3.** Mungesa e delegimit të mirëfilltë për nxjerrjen e akteve nënligjore, në kundërshtim me nenin 118 të Kushtetutës, në shumicën e rasteve pa përcaktuar as llojin e aktit nënligjor, vërehet edhe në nenet: 10 pika 1 dhe 2, 14, 15 pika 6, 45, 51 pika 3, 70 shkronja “b”, 77 pika 3 dhe 5, apo në nenin 83.

Ndërsa parashikimet e:

- pikës 3, të nenit 51 që përcakton se:

“Subjekti kërkues për licencë burse DLT ose, sipas rastit, bursa DLT e licencuar, duhet të përmbushë gjithashtu çdo detyrim shtesë që mund të lindë si rrjedhojë e akteve nënligjore të nxjerra në vazhdimësi/në të ardhmen. Aktet nënligjore rregullatore respektive për secilin autoritet përgjegjës, në zbatim të këtij ligji, të cilat ndikojnë në veprimtarinë dhe/ose kushtet dhe kriteret e licencimit të bursave DLT, të cilat janë licencuar përpara hyrjes në fuqi të këtyre akteve, do të shtrijnë efektin te këto bursa DLT vetëm 15 ditë pune pas hyrjes në fuqi të tyre. AMF-ja, sipas rastit, mund të përcaktojë një afat më të shkurtër kohor, por në asnjë rast, më të shkurtër se 10 ditë pune nga data e hyrjes në fuqi të akteve nënligjore.”; apo

- pikës 5, të nenit 63 që përcakton se:

“Subjekti kërkues për licencë si ofrues i shërbimeve inovative ose, sipas rastit, ofruesi i shërbimeve inovative i licencuar duhet të përmbushë gjithashtu çdo detyrim shtesë që mund të lindë si rrjedhojë e akteve nënligjore të nxjerra në të ardhmen.”;

- pikës 6, të nenit 63 që përcakton se:

“Aktet nënligjore të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të këtij ligji, të cilat ndikojnë në veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve inovative të licencuar përpara hyrjes në fuqi të këtyre akteve, shtrijnë efektin te këta ofrues të shërbimeve inovative vetëm 15 dite pune pas hyrjes në fuqi të tyre. AKSHI, sipas rastit, mund të përcaktojë një afat më të shkurtër kohor, por jo më të shkurtër se 10 ditë pune nga data e hyrjes në fuqi të akteve nënligjore.”

- Pikës 3, të nenit 77, që përcakton se:

*“Subjekti kërkues, për t’u pajisur me licencë si kujdestar i portofolit të palëve të treta, përmbush çdo detyrim të përcaktuar nga aktet nënligjore ose rregullatore në zbatimin e këtij neni. Në rast se kërkesa e subjektit kërkues është paraqitur përpara hyrjes në fuqi të aktit nënligjor ose rregullator, autoriteti përgjegjës njofton kërkuesin për nevojën për plotësimin e aplikimit me kërkesat e reja, duke i lënë për këtë qëllim kohën e nevojshme, por në çdo rast jo më të shkurtër se 10 ditë pune nga e nesërmja e hyrjes në fuqi të aktit nënligjor ose rregullator. Në këtë rast afatet e përcaktuara në nenin 11, të këtij ligji, pezullohen për aq kohë sa i është lënë në dispozicion aplikuesit për plotësimin e aplikimit.”;*

përveçse janë në kundërshtim me nenin 118 të Kushtetutës, cenojnë direkt sigurinë juridike dhe nenin 11 të Kushtetutës që mbron lirinë e veprimtarisë ekonomike.

Kushtet dhe kriteret që përbëjnë detyrim për subjektin e licencuar, ashtu si dhe aktet nënligjore që me autorizim të ligjvënësit (autorizim i formuluar në përputhje me kërkesat e nenit 118, paragrafi 2 i Kushtetutës) do të duhet të përcaktojnë kushte, kritere, apo detyrime për subjektin kërkues, duhet të jenë të përcaktuara qartë në ligj.

Një autorizim si dispozitat e sipërcituara, bën që çdo akti rregullues që mund të dalë në vijim nga autoritetet, t'i mungojë baza ligjore dhe të jetë i pazbatueshëm. Ashtu siç nuk mundet që, të shqyrtohen kërkesat për licencim, pa u plotësuar kuadri nënligjor, siç përcaktohet në disa dispozita të ligjit (për ilustrim, neni 29, pikat 5 dhe 6, neni 51 pikat 3 dhe 4, neni 63 pikat 6 dhe 7, neni 77, pika 4, neni 82, pikat 3 dhe 4, etj.).

4. Hapësirë e gjerë vlerësimi u lihet autoriteteve edhe në nenin 13, shkronjat “c)” dhe “ç)”, apo neni 44, shkronja “ç)”, duke bërë përcaktime jo mbi kritere objektive të matjes së “mjaftueshmërisë” apo “pamjaftueshmërisë”, apo për gjykimin nga autoriteti përgjegjës se subjekti do të jetë i aftë ose jo të plotësojë në të ardhmen kushtet dhe kriteret për licencimin.

5. Neni 49 i ligjit parashikon se:

*“1. Në rast se emetuesi pranon para FIAT në këmbim të tokenëve digjitalë/monedhave virtuale të emetuara përmes një STO-je ose ICO-je, emetuesi detyrohet të hapë një llogari në një bankë ose degë të bankës së huaj me seli në Shqipëri, të licencuar nga Banka e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë, me qëllim depozitim të këtyre parave.*

*2. Paratë FIAT të pranuar nga emetuesi qëndrojnë në një llogari bankare të veçuar nga aktivet e bankës/degës së bankës deri në mbylljen e ofertës së STO-së apo ICO-s.”*

Kjo dispozitë evidenton një problematikë të theksuar lidhur me kryerjen e transaksioneve me monedhat virtuale. Nëse transaksioni kryhet duke pranuar para FIAT, atëherë duhet të hapet një llogari bankare dhe të lihet gjurmë, të kontrollohet burimi, lloji i transaksionit, kontrolli i parasë (nëse bëhet fjalë për pastrim parash, apo jo), si dhe lind detyrimi fiskal nga transaksioni.

Por nuk ka asnjë përcaktim, se si do të kryhen gjithë këto procese verifikuese në këtë rast. Kjo mungesë sigurie që shkakton ky ligj për të verifikuar dhe kontrolluar elementet e mësipërme, krijon premise direkte për shmangien e zbatimit të legjislacionit në fuqi në vend.

Ky verifikim pamundësohet në këtë rast konkret (kur emetuesi mund të pranojë para FIAT në këmbim të tokenëve digjitalë/monedhave virtuale), ndërsa për rastin kur nuk pranohet paraja FIAT dhe ka vetëm tregtim elektronik nga emetuesit, ligji nuk parashikon asnjë mjet kontrolli efektiv si më sipër.

6. E njëjta problematikë si më sipër është dhe lidhur me zbatimin e detyrimeve tatimore. Neni 105 i ligjit parashikon se, personat fizikë dhe juridikë, subjekte të këtij ligji, i nënshtrohen sistemit tatimor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Ndërkohë që, në rastin konkret, bëhet fjalë për transaksione që mund të mos lënë asnjë gjurmë. Në këto kushte, si do të mblidhen detyrimet tatimore për këto transaksione? Ky është një shqetësim edhe për vendet e zhvilluara sa u takon transaksioneve me monedha virtuale.

Kësisoj, ky ligj, nisur dhe nga vlerat e larta monetare që mund të tregtohen (mbi 1 000 000 Euro, referuar nenit 33 të ligjit), krijon një regjim të ri, të pabarabartë, për zotëruesit e këtyre shumave monetare, në raport me pjesën tjetër të subjekteve në Republikën e Shqipërisë, që për çdo transaksion, paguajnë detyrimin përkatës tatimor.

Ndaj parashikimet e këtij ligji, shoqëruar me pamundësitë e gjurmimit të transaksioneve dhe mungesën e harmonizimit të tij me pjesën tjetër të legjislacionit në fuqi, përfshirë atë tatimor, cenon nënin 18 të Kushtetutës.

7. Disa dispozita të këtij ligji parashikojnë se cilat veprime apo mosveprime përbëjnë vepra penale të dënueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, në kundërshtim me nenin 116 të Kushtetutës. Konkretisht:

Neni 88, pika 6, e ligjit parashikon se:

“Ushtrimi i veprimtarive që përbëjnë sjellje të jashtëligjshme, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, konsiderohen vepra penale në kuptim të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.”

Neni 90, pika 3, parashikon se:

“Kryerja e veprimeve në kundërshtim me pikën 1, këtij neni, konsiderohen vepra penale në kuptim të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.”

Neni 92, pika 1, parashikon se:

“Për qëllime të vlerësimit të prezencës ose jo të veprës penale të parashikuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, lidhur me përdorimin e paautorizuar dhe përhapjen e informacionit të privilegjuar, autoritetet përgjegjëse gjatë hetimit administrativ vlerësojnë edhe nëse informacioni i privilegjuar përfshin: ë...ç”

Parashikime të ngjashme janë bërë dhe në ligjin nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”, ligj i cili është kthyer për rishqyrtim. Edhe në këtë rast, risjellim në vëmendjen tuaj se:

Përcaktimi i veprave penale bëhet vetëm në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Është ky akt ligjor, miratuar me shumicë të cilësuar, që ka përcaktuar se cilat veprime apo mosveprime të kryera në cenim të marrëdhënieve të caktuara shoqërore të mbrojtura nga legjislacioni penal, konsiderohen si vepra penale.

Parashikimi i bërë në këto dy nene që përpiqen t'i klasifikojë veprimet e rregulluara nga ligji si konsumim i një vepre penale të sipas Kodit Penal, duke zgjeruar apo ngushtuar kuptimin e zbatimit të tij, cenon hierarkinë e akteve dhe bie ndesh me nenin 116 të Kushtetutës.

Neni 1 i Kodit Penal parashikon se, është ligji penal ai që përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre.

Gjykata Kushtetuese ka theksuar se, Kodi Penal përbën ligjin më të rëndësishëm, ku përfshihen në mënyrë të sistemuar dispozitat penalo-juridike. Një nga parimet kryesore që përshkon këtë Kod është edhe parimi i ligjshmërisë që nënkupton parashikimin me ligj të veprave penale dhe

mosdënimin për një veper penale që nuk është parashikuar shprehimisht si krim ose kundërvajtje penale.

Dispozita, që e klasifikon një veprim të caktuar si veper penale jashtë dispozitave të Kodit Penal dhe si pjesë e një ligji të miratuar me shumicë të thjeshtë të deputetëve, bie ndesh me parimin e kushtetutshmërisë, pasi prek drejtpërdrejt shtetasit në të drejtat dhe liritë e tyre, duke mosrespektuar shumicën e cilësuar për këtë qëllim, të parashikuar nga neni 81 pika 2 të Kushtetutës (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 5.02.2010).

2 Ligjet e zakonshme nuk mund të trajtojnë çështje që janë parashikuar të trajtohen nga kodet apo ligjet organike. Nëse kushtetutëbërësi do të kishte dëshiruar një trajtim të njëjtë të tyre, neni 81, pika 2, i Kushtetutës nuk do të ekzistonte. ë...ç. Legjislacioni penal ka për detyrë të mbrojë vlera të rëndësishme të tilla si pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e tij territoriale, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën etj. (shih nenin 1/b të Kodit Penal).

Ky legjislacion është një tregues kuptimplotë për çdo vend, në kuptimin se sa ai është në gjendje të balancojë të drejtën e shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror nga njëra anë, me të drejtat dhe liritë e individit nga ana tjetër. Në vlerësimin e Gjykatës kjo është, gjithashtu, një arsye tjetër që e ka detyruar kushtetutëbërësin të kërkojë një konsensus më të gjerë nga forcat politike të përfaqësuara në Kuvend, me qëllim që sanksionet penale të parashikohen vetëm për ato lloj veprimesh ose mosveprimesh, të cilat, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, të jenë të krahasueshme për nga rëndësia me vlerat që mbrojnë.

8. Neni 100 i ligjit parashikon dispozitën e rendit të përmbushjes së pretendimeve për shlyerjen e detyrimeve ndaj kreditorëve dhe aksionarëve, në rastin e likuidimit. Radha e preferimit në përmbushjen e detyrimeve është e përcaktuar në nenin 605 të Kodit Civil dhe kjo radhë nuk mund të ndryshohet nga ky ligj me shumicë të thjeshtë, në përputhje me hierarkinë e akteve sipas nenit 116 të Kushtetutës. Në vetvete, neni 605 i Kodit Civil, në paragrafin e fundit, parashikon përjashtim nga kjo radhë specifike e preferimit, vetëm për procedurën e falimentimit të parashikuar në ligjin nr. 110/2016 “Për falimentimin”.

#### **IV. DISKUTIMI NË KOMISION.**

Përfaqësuesit e institucionit të Presidentit të Republikës paraqitën dekretin dhe arsyetimin përkatës për kthimin e ligjit nr. 66/2020.

Relatori ritheksoi argumentet kryesore mbështetëse për ligjin nr. 66/2020, si dhe paraqiti mendimin e tij për secilën prej çështjeve të trajtuara në dekret, si më poshtë:

#### **IV. 1. Vlerësimi për ligjin nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”.**

Ligji nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë” është një ligj mjaft i rëndësishëm për tregun financiar dhe ekonominë e vendit tonë, si dhe është punuar me cilësinë e duhur, për disa arsye, si më poshtë:

**Së pari**, ligji lindi si nevojë e tregut financiar, në kushtet e zhvillimit të shpejtë teknologjik dhe përhapjes së përdorimit të aktiveve virtuale e shërbimeve financiare të lidhura me to. Përfshirja gjithnjë e më shumë e investitorëve dhe ofruesve të infrastrukturës së tregjeve financiare bëri të nevojshëm rregullimin e tregut të aktiveve virtuale dhe të pjesëmarrësve në këtë treg.

**Së dyti**, tregjet e aktiveve virtuale, aktualisht, janë të parregulluara nga legjislacioni dhe mbartin një sërë rreziqesh të mundshme, siç janë krijimi i skemave mashtruese apo skemave të paautorizuara për të ofruar aktive virtuale, rreziku i përdorimit të aktiveve virtuale për të pastruar para, si dhe manipulimi i tregut. Prandaj nevojitet një kornizë ligjore e plotë në mënyrë që ky aktivitet të rregullohet.

**Së treti**, direktiva 2018/843 përcakton detyrimin e autoriteteve përkatëse të shteteve anëtare të BE-së për të regjistruar ose licencuar ofruesit e shërbimeve të lidhura me monedhat virtuale/tokenat digjitalë. Gjithashtu, organizata ndërqeveritare Financial Action Task Force (FATF) rekomandon identifikimin e autoritetit përgjegjës dhe regjistrimin ose licencimin e të gjithë ofruesve të shërbimeve të mjeteve virtuale në shtetin në të cilin janë krijuar.

**Së katërti**, përcaktimi i kuadrit ligjor dhe ecuria e mirë e tregjeve të aktiveve virtuale pritet të sjellin një shfrytëzim më të mirë të zhvillimeve teknologjike; uljen e kostove të sistemit të pagesave; nxitjen e financimeve për ekonominë e vendit, nëpërmjet burimeve alternative të financimit; tërheqjen e investitorëve të huaj dhe krijimin e përfitimeve ekonomike për vendin.

**Së pesti**, ligji 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë” është hartuar në përputhje me kushtetutën dhe legjislacionin e brendshëm të vendit tonë, si ligjin nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar; ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; ligjin nr.9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjin nr.9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar; ligjin nr.7895, datë 27.1.1992 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë“, të ndryshuar etj. Për këtë arsye, Kuvendi e miratoi këtë ligj me shumicë votash.

**Së gjashti**, shqyrtimi i këtij ligji nga Kuvendi mori kohën e nevojshme dhe u zhvillua me prezencën e të gjitha institucioneve që kanë punuar për hartimin e tij, si Ministria e Financave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Banka e Shqipërisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit. Të gjitha këto institucione e vlerësuan këtë ligj të rëndësishëm për rregullimin e tregjeve të aktiveve virtuale dhe parandalimin e risqeve që mund të vijnë prej tyre.

*Së shtati*, Komisioni mori në konsideratë dhe përfshiu në ligj edhe komentet e paraqitura nga Shoqata Shqiptare e Bankave.

#### **IV.2. Mendime për çështjet e trajtuara në dekretin e Presidentit të Republikës dhe argumentet përkatëse.**

Mendimi i përgjithshëm për argumentet e dhëna në arsyetimin e dekretit është se:

*Së pari*, pretendimet se në vendin tonë nuk janë plotësuar parakushtet dhe standardet për funksionimin efektiv të tregjeve të kapitalit nuk qendrojnë. Ligji përcakton rregullat për të gjitha pretendimet e dekretit për këtë çështje, siç janë sanksionet për rastet e pamundësisë financiare apo operacionale të subjekteve, informimi i klientëve dhe publikut mbi risqet e mundshme dhe tarifatat, konsensusi i përdoruesve të parasë virtuale, masat dhe politikat për parandalimin e mashtrimit dhe abuzimit me tregun, forcimi i sigurisë së sistemit teknologjik, mbrojtja e klientëve etj.

*Së dyti*, lidhur me risqet e mundshme për parandalimin e parave dhe financimit të terrorizmit, ritheksoj se ligji mbështetet në rekomandimet e direktivave të BE-së, si dhe të Organizatës Ndërqeveritare të Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF) për krijimin e një mjedisi ligjor dhe rregullator për përdorimin e parasë virtuale dhe teknologjisë së regjistruar të shpërndarë. Gjithashtu, ligji përcakton rregullat për parandalimin e këtij fenomeni dhe vendos sanksionet për rastet e shkeljeve ligjore.

*Së treti*, ligji përcakton rregullat për të gjitha problematikat e paraqitura në arsyetimin e pikës III të dekretit, siç janë tregtimi i tokenëve digjitalë të aseteve, nxjerrja e akteve nënligjore dhe krijimi i fleksibilitetit të nevojshëm për këtë çështje, vlersimi i situatës aktuale dhe i perspektivës financiare të aksionarit, verifikimi dhe raportimi i transaksioneve të dyshimta, mbledhja e detyrimeve tatimore, vendosja e sanksioneve në përputhje me Kodin Penal, përcaktimi i rendit të shlyerjes së detyrimeve në përputhje me Kodin Civil dhe Kushtetutën.

Më poshtë paraqes mendimet e detajuara sipas pikave e nënpikave të dekretit:

***Lidhur me argumentin I.*** Rregullimi i emetimit të tokenëve digjitalë dhe/ose të monedhave virtuale edhe pse është një risi teknologjike që përmban anë pozitive, në kushtet akutale, për shkak të mungesës së plotësisë të kushteve dhe standardeve që kërkojnë tregje të tilla të regjistruar të shpërndarë, mund të jetë një proces i parakohshëm për t'u miratuar e zbatuar.

***Lidhur me argumentin I.1:*** Vlerësohet të ketë pak ose aspak mundësi mbikëqyrjeje nga rregullatori kur situata del nga kontrolli.

Ligji 66/2020 parashikon qartazi kërkesat dhe procedurat e licencimit të subjekteve që operojnë në tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistruar të shpërndarë, si dhe funksionet mbikëqyrëse të autoriteteve përgjegjëse. Në rast të vështirësive ekonomike (pamundësi

financiare) apo operacionale të subjekteve, si dhe në rastet kur konstatohen shkelje të dispozitave, ligji parashikon masa administrative dhe penale, si dhe procedura të hollësishme në lidhje me likudimin vullnetar dhe atë të detyruar.

***Lidhur me argumentin 1.2: Vlera e tokenëve digjitalë dhe/ose të monedhave virtuale luhatet në mënyrë drastike dhe përdorimi i monedhës varet kryesisht nga disponueshmëria e internetit.***

Ligji 66/2020 përcakton procedurat dhe dokumentet e subjektit të licencuar që të informojë përdoruesit, në mënyrë të përshtatshme, mbi rreziqet që mund të rrjedhin nga luhatshmëria e monedhës.

Në mënyrë që përdoruesit të vetëdijësohen dhe informohen në mënyrë të përshtatshme mbi rreziqet që mund të rrjedhin nga luhatshmëria e monedhës, ligji 66/2020 përcakton se:

- në rastin e bursës DLT mbajtëse të kategorisë së licencës A dhe B, subjekti i licencuar duhet të sigurohet se klienti ka deklaruar me shkrim se i kupton të gjitha rreziqet e tregtimit në këtë bursë, si edhe se mund të humbasë pjesërisht apo tërësisht kapitalin e vet;
- në rastin e bursës DLT, mbajtëse të kategorisë së licencës C, të kryejë një vlerësim paraprak të njohurive dhe përshtatshmërisë së klientëve, sipas përcaktimeve të seksionit II, të kreut IV, të ligjit “Për tregjet e kapitalit;
- në rastin e ofertave fillestare të tokenit digjital/monedhës virtuale me vlerë mbi tetë milionë euro ose shumën e barazvlefshme të saj në lekë, emetuesi duhet fillimisht të publikojë një relacion prezantues të miratuar nga autoriteti përgjegjës, i cili ndër të tjera duhet të ofrojë informacion të detajuar lidhur me rreziqet kryesore, të parashtrijë specifikat teknologjike të tokenit digjital të shërbimeve, tokenit digjital të pagesave, tokenit digjital të aseteve apo monedhave virtuale;
- në rastin e ofertave të tokenit digjital të titujve me vlerë mbi 1 milion euro ose shumën e barazvlefshme të saj në lekë, emetuesi të publikojë një prospekt të plotë, i cili ndër të tjera duhet të përmbajë në mënyrë të dukshme seksionin “Faktorët e rrezikut”, që duhet të përfshijë një përshkrim të faktorëve të rrezikut me rëndësi thelbësore të lidhura me emetuesin për një numër të kufizuar kategorish;
- në rastin e ofertave fillestare të tokenit digjital/monedhës virtuale me vlerë nën tetë milionë euro ose shumën e barazvlefshme të saj në lekë, emetuesi duhet të publikojë një dokument informues për publikun, forma dhe përmbajtja e të cilit përcaktohet përmes rregullores së nxjerrë nga AMF-ja;
- në rastin e ofertave të tokenit digjital të titujve me vlerë nën 1 milionë euro ose shumën e barazvlefshme të saj në lekë, emetuesi duhet të publikojë një aktofertë sipas kërkesave të ligjit për tregjet e kapitalit.

**Lidhur me argumentin 1.3:** *Shpejtësia e transaksionit dhe tarifat kanë tendencë të ndryshojnë në varësi të efikasitetit të punës për krijimin e tyre (minierave) dhe bllokimeve të rrjetit.*

Ligji 66/2020 rregullon tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë dhe jo mënyrën e krijimit të tyre, të cilat ndryshojnë krejtësisht nga njëra tjetra në varësit të llojit të teknologjisë së regjistrave të shpërndarë që përdoret. Disa sisteme të monedhave/tokenave preferojnë që monedhat/tokenat të krijohen përmes fuqisë kompjuterike të përdoruesve në zgjidhjen e algoritmeve të ndryshme (miniera) ndërsa disa të tjerë mund të preferojnë që i gjithë stoku i monedhës/tokenit të jetë i gatshëm për tu përdorur pa iu nënshtruar proceseve të tilla.

**Lidhur me argumentin 1.4:** *Shndërrimi i tokenëve digjitalë dhe/ose të monedhave virtuale në monedhe likuide është i kushtueshëm.*

Mesatarisht, tarifat për këmbimin e kriptomonedhave nga Bursat DLT variojnë nga 0.05% në 0.5% të vlerës së transaksionit dhe mesatarja e tarifës në ngarkim të përdoruesve përllogaritet të jetë në nivelin 0.25%.

Me qëllim sigurimin e transparencës dhe informimit të përshtatshëm në lidhje me tarifat, pika 1(b) e nenit 53 të ligjit 66/2020 përcakton qartë se Bursa DLT duhet të ndërmarrë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për t'u shpjeguar klientëve strukturën e tarifave, si dhe i informon ata në mënyrë të përshtatshme për të gjitha tarifat në ngarkim të tyre.

**Lidhur me argumentin 1.5.** *Nuk është i pranueshëm për çdo ofrues mallrash ose shërbimesh.*

Elementët thelbësorë të monedhave virtuale/tokenave digjitalë që emetohen përmes teknologjisë së regjistrave të shpërndarë janë:

- konsensusi i përdoruesve të tyre që monedha përkatëse mund të përdoret si mjet shkëmbimi, si dhe
- konsensusi i përbashkët i përdoruesve për verifikimin e të gjithë transaksioneve që kryhen në atë sistem dhe gjëndjes aktuale të monedhave/tokenave.

**Lidhur me argumentin 1.6:** *Struktura e “blockchain” do të thotë që çdo transaksion është përfundimtar dhe transaksionet janë të pandryshueshme.*

**Lidhur me argumentin 1.7:** *Nëse bie viktimë e një mashtrimi ose bëhet një blerje aksidentale, nuk ka asnjë mënyrë që ky transaksion të anulohet.*

Pandryshueshmëria e transaksioneve ose e thënë ndryshe, pamundësia e palëve për të ndërhyrë në sistem duke ndryshuar të dhënat, konsiderohet si një nga avantazhet më të mëdha të teknologjisë së regjistrave të shpërndarë, duke e bërë atë të pavarur, transparente dhe të pamanipulueshme.

Për sa i përket rastit kur përdoruesit mund të bien pre e skemave të mashtrimit, neni 9 shkronja



“e” nënshkronja “iii” e ligjit nr. 66/2020 përcakton se çdo titullar i licencës “*duhet të miratojë rregullore të brendshme të funksionimit, të cilat duhet të përmbajnë masa dhe politika efikase për parandalimin e mashtrimit dhe abuzimit me tregun*”. Së dyti, neni 89 i ligjit përcakton në mënyrë të qartë të gjitha veprimtaritë që do të konsiderohen si manipulim i tregut, të cilat përfshijnë edhe mashtrimin.

Ndërkaq, neni 55 përcakton detyrimin e Bursave DLT, të centralizuar, për të miratuar dhe për të **ndërmarrë të gjitha masat e sigurisë së mëposhtme lidhur me ngritjen e një sistemi të brendshëm të qëndrueshëm, të aftë për të parandaluar e përballuar sulme kibernetike, si dhe për t’u ofruar klientëve një mjet rekursi në rast të humbjes së fondeve:**

- a) identifikimi me dy faktorë i përdoruesve;
- b) Whitelisting” i adresave të IP-së së përdoruesve;
- c) përdorimi i “off-line storages”;
- ç) përdorimi i portofoleve digjitale me shumë nënshkrime;
- d) kryerja e testeve periodike për të verifikuar qëndrueshmërinë e sistemit;
- dh) kryerja e testeve periodike të penetrimit, për të verifikuar sigurinë kibernetike të sistemit;
- e) kryerja e minimalisht një auditimi vjetor, me qëllim vlerësimin e mirëmbajtjes dhe efikasitetit të masave të sigurisë, listuar në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” të këtij neni.

I njëjti detyrim për ngritjen e një sistemi të brendshëm të qëndrueshëm, të aftë për të parandaluar dhe përballuar sulme kibernetike, si dhe për t’u ofruar klientëve një **mjet rekursi në rast të humbjes së fondeve** përcaktohet edhe në nenin 77 për Kujdestarët e Portofoleve të Palëve të Treta.

Së fundmi, në rast të konstatimit të skemave mashtruese, neni 99, në pikat 4 dhe 5 të tij, përcakton se: “4. Pasuritë e klientëve të titullarit të licencës, qofshin këto para FIAT ose token digjital/monedha virtuale, mbahen në llogari ose portofola të veçantë nga llogaritë ose portofola të vetë shoqërisë në fjalë dhe nuk preken gjatë procesit të likuidimit të detyruar.

5. AMF-ja, për të siguruar mbrojtjen e klientëve individë të titullarit të licencës, mund të kërkojë që klientët përkatës dhe pasuritë e tyre, qofshin këto në para FIAT ose token digjital/monedha virtuale, t’i transferohen një shoqërie tjetër që ushtron veprimtari të njëjtë. Në rastet kur kjo është e pamundur, titullari i licencës duhet t’i transferojë pasuritë e klientëve në mënyrë të drejtpërdrejtë te llogaritë personale bankare ose portofolet e tyre, sipas udhëzimeve të këtyre të fundit.”

**Lidhur me argumentin 1.8:** Shumë çelësa privatë (kode) të tokenëve digjitalë dhe/ose të monedhave virtuale kanë humbur, duke kontribuar kështu në deflacionin dhe mbivlerësimin e vlerës së tyre.

Sikurse ndodh rëndom që paratë fizike mund të humbasin, e njëjta gjë vlen edhe për fjalëkalimet e portofoleve të monedhave virtuale/tokenave digjitalë. Deri më sot, nuk ka asnjë të dhënë konkrete që humbja e fjalëkalimeve, të cilat mundësojnë akses në portofolet digjitalë, ka patur ndikim në deflacionin e ndonjë monedhe virtuale/tokeni digjital të caktuar.

***Lidhur me argumentin 1.9: Ndërfaqja e përdoruesit në shumicën e aplikacioneve DLT është ende e paqëndrueshme dhe rrjeti nuk është gati për t'u shërbyer të gjithëve në botë.***

Paqëndrueshmëria e ndërfaqeve, aplikacioneve të bazuara në DLT ka qënë një problematikë shqetësuese disa vite më parë, kur kjo teknologji ishte ende në fillimet e saj. Përparimi teknologjik, përdorimi masiv dhe eksperiencia e përfutur nga gabimet e hershme kanë rritur në mënyrë të ndjeshme performancën e këtyre aplikacioneve, duke i bërë më të qëndrueshme dhe më të sigurta.

Për më tepër, ligji nr. 66/2020 përcakton qartë detyrimin për emetuesin e ICO/STO dhe Bursën DLT për të ngritur sisteme të qëndrueshme dhe të afta për të përballuar ngarkesën e rrjetit dhe sulmet kibernetike.

Më konkretisht, neni 37 i ligjit përcakton se emetuesi është i detyruar të mirëmbajë protokollin e sistemit e të sigurisë në standardet më të larta të përshtatshme, ndërsa neni 55 përcakton detyrimin e Bursës DLT të centralizuar për të ***miratuar dhe ndërmarrë të gjitha masat e sigurisë së mëposhtme lidhur me ngritjen e një sistemi të brendshëm të qëndrueshëm, të aftë për të parandaluar e përballuar sulme kibernetike***, si dhe për t'u ofruar klientëve një mjet rekursi në rast të humbjes së fondeve.

I njëjti detyrim për ***ngritjen e një sistemi të brendshëm të qëndrueshëm, të aftë për të parandaluar dhe përballuar sulme kibernetike***, si dhe për t'u ofruar klientëve një mjet rekursi në rast të humbjes së ***fondeve*** përcaktohet edhe në nenin 77 për Kujdestarët e Portofoleve të Palëve të Treta.

***Lidhur me argumentin 1.10: Parimi i përdorimit të tokenëve digjitalë dhe/ose të monedhave virtuale shkon kundër institucioneve qeverisëse, politikës, bankave, rregullatorëve dhe kontrollit e ka të ngjarë të ndeshet me shumë rezistencë përpara se këta aktorë ta tolerojnë ose aprovonjë atë.***

Parimet e përdorimit të teknologjisë së regjistrave të shpërndarë jo vetëm që nuk shkojnë kundër institucioneve qeverisëse, politikës, bankave dhe rregullatorëve, por përkundrazi, kanë potencialin për t'i përfunduar ato edhe më tej, duke ofruar siguri, transparencë, optimizim të proceseve të brendshme dhe besim të automatizuar në ndërveprimin midis këtyre institucioneve dhe publikut të gjerë. Vende si Kanadaja, Danimarka, Estonia, Gjermania, Holanda, Gjeorgjia etj. po eksplorojnë aplikueshmërinë e teknologjisë blockchain në fusha të ndryshme, si administrimi i pronave, sistemet doganore, menaxhimi i identitetit, votimi, sistemet e sigurimeve shoqërore etj. Ndërkaq, bankat qendrore si ajo e SHBA-së apo ajo e Mbretërisë së Bashkuar po shqyrtojnë mundësitë për krijimin e një monedhe virtuale shtetërore.

***Lidhur me argumentin 2: Zbatimi i këtij ligji në kushtet aktuale të vendit tonë, shoqërohet me rreziqet e transaksioneve ilegale të pastrimit të parave dhe të shmangjes fiskale.***

Në datën 30 maj 2018, Parlamenti dhe Këshilli European miratuan direktivën 2018/843, e cila përfshiu për herë të parë monedhat virtuale/token-at digjitalë dhe ofruesit e shërbimeve të lidhura me to, si pjesë e kuadrit rregullator european për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, duke i quajtur ato si subjekte të detyruara për raportim.

Monedha Virtuale u përkufizua si *“përfaqësimi digjital i vlerës, i cili nuk është emetuar apo garantuar nga një organ shtetëror, nuk është domosdoshmërisht e lidhur me një monedhë të rregulluar me ligj, nuk është valutë dhe rrjedhimisht nuk ka kurs ligjor, por është pranuar nga personat fizikë apo juridikë si mjet shkëmbimi i cili mund të transferohet, depozitohet dhe tregtohet në mënyrë elektronike.”* Kujdestarët e Portofolit të Palëve të Treta u përkufizuan si entitete që ofrojnë shërbimin e ruajtjes, mbajtjes dhe/ose transferimit të monedhave virtuale.

**Gjithashtu, direktiva 2018/843 përcakton detyrimin e autoriteteve përkatëse të shteteve anëtare të BE-së për të regjistruar ose licencuar ofruesit e shërbimeve të lidhura me monedhat virtuale/tokenat digjitalë.**

Në muajin Qershor të vitit 2019, organizata ndërqeveritare Financial Action Task Force (FATF), rekomandimet e së cilës njihen si standardi më i lartë global i politikave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, publikoi udhëzuesin për rregullimin e Monedhave Virtuale dhe Ofruesve të Shërbimeve të Mjeteve Virtuale. Rekomandimet e këtij udhëzimi për përkufizimin ligjor të mjeteve virtuale dhe ofruesve të shërbimeve të mjeteve virtuale, si dhe masat që duhet të ndërmerren kundrejt tyre, janë implementuar plotësisht nëpërmjet ligjit nr.33/2019, datë 17.6.2019 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 ‘Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit’”*.

Më tej, FATF rekomandon identifikimin e autoritetit përgjegjës dhe regjistrimin ose licencimin e të gjithë ofruesve të shërbimeve të mjeteve virtuale në shtetin në të cilin ata janë krijuar.

Sic u përmend edhe më sipër, të gjitha rekomandimet e FATF në lidhje me mjetet virtuale dhe ofruesit e shërbimeve të mjeteve virtuale janë reflektuar plotësisht në kuadrin ligjor ekzistues për parandalimin e pastrimit të parave. Këto koncepte i përshtaten specifikave të tregjeve financiare të bazuara në DLT (teknologjinë e regjistrave të shpërndarë) ku kërkohet një mjedis i qartë ligjor në të cilin do operojnë ofruesit e shërbimeve të mjeteve virtuale. Këtij qëllimi i shërben Ligji 66/2020 dhe shihet qartë lidhja e ndërsjelltë e dy ligjeve në drejtim të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Tokenat digjitalë dhe monedhat virtuale, sic sqarohet edhe në Ligjin 66/2020 janë pjesë e mjeteve virtuale. Në nenin 16 të ligjit përcaktohet qartë detyrimi i emetuesve të tokenave digjitale dhe cdo personi që ofron shërbime në lidhje me tokenat digjitale për të zbatuar përgjegjësitë që rrjedhin nga Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Më tej, nenet 9, 37, 69 përcaktojnë detyrimin e qartë për çdo subjekt në lidhje me ngritjen e sistemeve dhe politikave të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Ligji 66/2020 synon të krijojë kushtet ligjore dhe rregullative në mënyrë që ekonomia të përfitojë nga ekzistenca dhe zhvillimi i tregjeve financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë, në zbatim edhe të rekomandimeve të FATF për licencimin ose regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të lidhura me to. Ndaj ky ligj duhet të shihet si plotësues i kuadrit rregullator për monitorimin sa më eficient të këtyre aktiviteteve.

Për sa i takon përkufizimit të pjesëmarrjes influencuese, të përcaktuar në nenin 3 pika 11 të ligjit, ky është përkufizim standard i përdorur gjerësisht në të gjitha ligjet e fushës financiare. Neni 21 i ligjit përcakton detyrimin e Autoritetit për miratimin e pjesëmarrjes influencuese, që gjithashtu është standard si tek ligjet e tjera.

Për analogji në ligjin nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, neni 2 pika 66 parashikohet “*Pjesëmarrja influencuese*” është zotërimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i 10 % ose më shumë i kapitalit ose të drejtave të votës ose zotërimi i pjesëmarrjes, e cila mundëson ushtrimin e influencës së konsiderueshme lidhur me administrimin e një shoqërie administruese të fondeve, depozitarin ose administruesin e fondeve të investimeve alternative ose depozitarin e fondeve të investimeve alternative në të cilën ekziston kjo pjesëmarrje”.

I njëjti parashikim është edhe në ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimi” neni 4 pika 28, në të cilin parashikohet se: “*Pjesëmarrje influencuese*” është zotërimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i aksioneve me të drejtë vote të kapitalit të një shoqërie sigurimi nga një person juridik ose fizik, i cili, i vetëm apo në bashkëpunim, zotëron 10 për qind ose më shumë të aksioneve me të drejtë vote të kapitalit të shoqërisë së sigurimit, përfshirë edhe rastin kur personi juridik ose fizik zotëron më pak se 10 për qind, por ushtron ndikim mbi administrimin e shoqërisë së sigurimit”.

***Lidhur me argumentin III:*** Disa dispozita të ligjit dhe shpjegimet e dhëna në relacionin shoqëruar paraqesin problematika.

***Lidhur me pikën III.1:*** Tregtimi i tokenëve digjitale të aseteve edhe pse është një nga mënyrat e reja më të përhapura të qarkullimit financiar, nuk merr aspak në konsideratë kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sa i takon mënyrës së transferimit dhe regjistrimit të pronësisë (psh të aksioneve të një shoqërie tregtare apo të pasurive të paluajtshme).

Tregtimi në një bursë DLT i tokenave digjitale të aseteve nuk do të thotë që në këto bursa do tregtohen asetet reale përmes tokenave digjitale, në Bursën DLT do tregtohen tokenat digjitale të aseteve, vlera e tregtimit të të cilave do të varet nga vlera e asetit përkatës.

***Lidhur me pikën III.2:*** Përdorimi i termave “i aftë dhe i përshtatshëm”, “vlerësimi i reputacionit profesional dhe personal” si kritere për licencimin e subjekteve dhe mungesa e delegimit të qartë për rregullimin e çështjeve sipas nenit 118 të Kushtetutës, lenë hapësira për abuzime gjatë zbatimit në praktikë të ligjit dhe ëojnë në cenim të lirisë së veprimtarisë ekonomike.

Termi “i aftë dhe i përshtatshëm” përdoret gjerësisht në legjislacionin financiar. Për një referim më të saktë dhe të plotë, pika 36 e nenit 3 të ligjit 66/2020 i referohet legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit.

Ndërkohë,

Pika 2 e nenit 9 përcakton aktin që do nxjerrë autoriteti përgjegjës (AMF apo AKSHI) në varësi me kompetencat e veta. Sipas përcaktimit në këtë pikë, akti lidhet me llojin dhe përmbajtjen e dokumentacionit që nevojitet për licencimin e subjektit përkatës.

Pika 3 e nenit 9 u jep autoriteteve përgjegjëse (AMF dhe AKSHI) të drejtën për të nxjerrë rregulla të detajuara, kritere të veçanta apo kritere të tjera shtesë për licencimin e subjekteve që operojnë në tregjet financiare të bazuara në DLT. **Meqënëse ky lloj tregu është i ri, me tendenca inovative, ku teknologjia ecën shpejt, ligji ka parashikuar të drejtën e autoriteteve përgjegjëse për të nxjerrë rregulla me kërkesa plotësuese apo shtesë.**

*Lidhur me pikën III.3. Mungesa e një delegimi të qartë të kompetencave për nxjerrjen e akteve nënligjore dhe periudha e shkurtër e hyrjes në fuqi të këtyre akteve janë në kundërshtim me nenin 118 të Kushtetutës, cenojnë sigurinë juridike dhe nenin 11 të Kushtetutës që mbron lirinë e veprimtarisë ekonomike, si dhe e bëjnë ligjin të pazbatueshëm.*

Përmbushja e funksionit rregullativ të tregjeve nën mbikqyrje, është një funksion që Autoriteti e realizon nëpërmjet nxjerrjes së rregulloreve, e parashikuar kjo shprehimisht, në disa dispozita të ligjit kuadër të funksionimit të Autoritetit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”.

Në respektim të parimit të hierarkisë së akteve, ku nxjerrja e rregulloreve, akteve nënligjore, duhet të autorizohet nga dispozita përkatëse e ligjit, në rreth 20 dispozita të ligjit nr.66/2020 është parashikuar një gjë e tillë.

Por, nisur nga specifika e përdorimit të shërbimeve financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë (“Distributed Ledger Technology” - DLT), që i japin përdoruesit të drejta përfitimi, pronësie apo përdorimi si instrument pagese, mjet utilitar në procesin e blerjes së produkteve apo të shërbimeve, zhvillimi me një dinamikë e shpejtësi të këtyre tregjeve financiare kërkon të njëjtën shpejtësi reagimi nga rregullatori. Përcaktimi në ligj i mundësisë së nxjerrjes së një akti nënligjor, në vlerësim të momentit kur akti do të jetë i nevojshëm, i jep Autoritetit të drejtën për të reaguar në kohën e duhur dhe aktit nënligjor, bazën ligjore për nxjerrjen e tij.

Qëllimi është arritja e objektivit për tregje të sigurta, transparente dhe në mbrojtje të investitorit.

Në rast të kundërt, do të kërkohej ndryshimi i ligjit në mënyrë të vazhdueshme dhe në varësi të zhvillimeve të shpejta, çka kërkon kohë, sepse dihen afatet dhe procedurat legjislative, nga njëra anë dhe nga ana tjetër Autoriteti nuk mund të kryejë detyrën për të cilën është krijuar dhe funksionon, pra detyrën e rregullatorit të tregut. Përfshirja e dispozitave që normalisht duhet të jenë në akte nënligjore në ligjet që i delegojnë këto, mund të krijojë kompleksitet dhe një ngurtësi të panevojshme, sepse në qoftë se ato duhet të ndryshohen, do të kërkohej procedura të gjata në Kuvend.

Kushtetuta në nenin 118 të saj përcakton se, dispozita për nxjerrjen e akteve nënligjore duhet të specifikojë autorizimin për nxjerrjen e akteve nënligjore, organin që ngarkohet për nxjerrjen

e akteve nënligjore, çështjet që duhet të rregullojnë këto akte, si dhe parimet mbi të cilat ato mbështeten. Mbi këto parime janë parashikuar dhe dispozitat të cilat autorizojnë Autoritetin si dhe Këshillin e Ministrave për nxjerrjen e rregullave shtesë në bazë dhe për zbatim të ligjit 66/2020.

Këto akte nënligjore nuk e tejkalojnë ligjin, përkundrazi për zbatimin më të mirë të tij, parashikohet që në të ardhmen nëse është e nevojshme, pra praktika e kërkon, mund të dalë akt nënligjor që e detajon ligjin brenda kufijve, parimeve dhe kuadratit të caktuar ligjor.

Në nenet 51/3, 63/5, 63/6 dhe 77/3 është parashikuar e drejta e autoritetit përgjegjës për kërkesa shtesë në lidhje me subjektin përkatës. Për një treg të ri, siç është tregu financiar i mbështetur në teknologjinë DLT, ku teknologjia evoluon në mënyrë të shpejtë, është e pamundur të përcaktohen në ligj të gjitha kushtet, kriteret, detyrimet për subjektin që operon në këtë treg. Për këtë arsye, ligjvënësi i ka dhënë të drejtë autoritetit përgjegjës të nxjerrë akte nënligjore dhe rregullatore për t'iu përshtatur zhvillimeve inovative. Për më tepër, sic shihet nga nenet e mësipërme, afati i implementimit të kërkesave të reja për subjektet që kanë marrë më parë licencën është jo më shumë se 15 ditë pune, pasi:

- Kërkohej përshtatje sa më e shpejtë me zhvillimet e reja teknologjike;
- Kërkohej trajtim i barabartë mes subjektit të ri dhe subjektit ekzistues.

Në nenin 3, pika 12 të ligjit 66/2020, është përcaktuar se “Autoritetet përgjegjëse” janë Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Ushtrimi i kompetencave përcaktohet mënyrë ekskluzive vetëm nga njëri autoritet, por gjithashtu parashikohet edhe ushtrimi i kompetencave të përbashkëta.

Në ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, neni 3 pika 2 e ligjit është përcaktuar se “Autoriteti ka të drejtë të nxjerrë akte, që janë rregulloret, rregullat, udhëzimet, manualët apo metodologjitë e miratuara nga Bordi i Autoritetit, në zbatim të kompetencave të parashikuara në këtë ligj apo në legjislacionin përkatës në fuqi, për përmbushjen e funksioneve rregullatore dhe mbikëqyrëse, si dhe për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit” si institucion i pavaruar.

Ndërsa për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, aktet nënligjore rregullatore do të nxirren nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Ministrave. Për këtë arsye, në ligj dispozitat për delegimin kanë përcaktuar nxjerrjen e akteve nënligjore rregullatore respektive, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, sipas këtij ligji, për miratimin e rregullave më të detajuara.

***Lidhur me pikën III.4. Ligji i jep Autoritetit hapësirë të gjerë veprimi për të gjykuar (mbi baza të arsyeshme) për rastet e refuzimit të licencës apo të autorizimit, si dhe nëse subjekti do të jetë i aftë dhe i përshtatshëm në të ardhmen që të plotësojë kushtet dhe kriteret për licencim.***

Rregullatorët e tregjeve financiare, sot, marrin vendime për licencimin apo refuzimin e licencës së një subjekti jo vetëm mbi bazën e dokumentacionit të përcaktuar nga ligji, por edhe mbi gjykimin nëse subjekti do jetë i aftë për të plotësuar kërkesat në të ardhmen apo jo. Kështu, nëse subjekti në momentin e licencimit zotëron kapitalin minimal të nevojshëm për marrje licence, rregullatori vlerëson edhe më tej situatën financiare të aksionarit, për të gjykuar se

financiarisht ai është i aftë për të përballuar edhe në të ardhmen nevojat për kapital. Pra, vendimarrja sot ka një qasje drejt vlerësimit dhe mbikqyrjes me bazë risku, përtej vlerësimit dhe mbikqyrjes mbi bazë rregullash.

***Lidhur me pikën III.5.*** Ligji ka problematika në drejtim të kontrollit të transaksioneve me para virtuale. Për transaksionet me para FIAT nuk parashikohen rregullat për kryerjen e verifikimeve të nevojshme, ndërsa për transaksionet e tjera që kryhen në rrugë elektronike nuk parashikohet asnjë mjet kontrolli.

Në rastin kur emetuesi pranon paratë FIAT detyrohet të hapë llogari pranë një banke, dhe në këtë rast banka bën verifikimin e klientit. Por edhe në çdo rast tjetër të emetimit të tokenave digjitale apo monedhave virtuale dhe të transaksioneve me to, sipas nenit 16 të ligjit 66/2020, çdo titullar i licencës, çdo emetues i tokenave digjitale si dhe çdo person tjetër që ofron shërbime në lidhje me tokenat digjitale, detyrohet:

- Të ushtrojë vigjilencën e duhur/apo të zgjeruar ndaj klientëve,
- Të kryejë një vlerësim të riskut ndaj klientëve,
- Të raportojë transaksionet e dyshimta tek autoritetet përkatëse.

***Lidhur me pikën III.6:*** Transaksionet me monedha virtuale, të cilat kanë vlera të larta monetare, mund të mos lenë gjurmë dhe paraqesin vështirësi për mbledhjen e detyrimeve tatimore, duke krijuar pabarazi me subjektet e tjera që paguajnë detyrime tatimore, gjë që cenon nenin 18 të Kushtetutës.

Ligji nr.66/2020 nuk është ligj tatimor dhe nuk mund të ketë dispozita më të shtjelluara lidhur me detyrimet tatimore. Sipas këtij ligji, subjektet që operojnë në tregjet financiare të bazuara në teknologjinë DLT janë subjekte që licencohen dhe mbikëqyren nga autoritetet përgjegjëse dhe i nënshtrohen, pa përjashtim, detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni tatimor në fuqi.

Nëse gjatë zbatimit të ligjit nr.66/2020 do të identifikohen problematika apo boshllëqe në legjislacionin tatimor, për arsye se është një veprimtari e re dhe me specifika të veçanta, do të merren masa për të bërë ndryshimet, plotësimet apo saktësimet e nevojshme në legjislacionin tatimor.

***Lidhur me pikën III.7:*** Disa dispozita të këtij ligji parashikojnë se cilat veprime apo mosveprime përbëjnë vepër penale të dënueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, në kundërshtim me nenin 116 të Kushtetutës.

Kodi Penal njih parashikimin e veprave penale në ligje të tjera. Neni 1/a i Kodit Penal parashikon se “Legjislacioni penal përbëhet nga ky Kod dhe nga ligje të tjera që parashikojnë vepra penale”.

Për sa i përket nenit 88 pika 6, nenit 90 pika 3 dhe nenit 92 pika 1, ligjvënësi nuk ka caktuar masë dënimi dhe as ka bërë përshkrim të veprës penale, por ka cituar se ushtrimi i veprimtarive që përbëjnë sjellje të jashtëligjshme, të përcaktuara në nenet e sipërcituara, konsiderohet veprë penale në kuptim të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Te të gjitha nenet e sipërcituara, përmenden sjelljet e paligjshme që konsiderohen vepra penale, por në kuptimin që i jep vetë Kodi Penal (psh. “mashtrimi” i parashikuar në nenin 143 të Kodit Penal, Neni 143/a/1 “Manipulimi i Tregut”, neni 143/a2 “Përdorimi i paautorizuar dhe përhapja e informacionit të privilegjuar”).

Ligjvënësi nuk ka parashikuar një normë të re, por ka konfirmuar atë që është e parashikuar në Kodin Penal.

***Lidhur me pikën III.8: Përcaktimi në ligj i rendit të shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve dhe aksionarëve, në rastin e likuidimit të shoqërisë, është në kundërshtim me Kodin Civil dhe me hierarkinë e akteve të parashikuar në nenin 116 të Kushtetutës.***

Për pjesën e likuidimit ligji nuk ishte i plotë, ndaj Komisioni për Ekonominë dhe Financat shtoi disa nene në ligj.

Në të gjithë kreun e likuidimit janë përcaktuar vetëm rregullat specifike për këtë lloj tregu, që operon në bazë të teknologjisë së regjistrave të shpërndarë, me qëllim rregullimin e procedurës së likuidimit të veprimtarive të titullarëve të licencës. Për këtë arsye, është parashikuar dhe dispozita referuese në legjislacionin tregtar për rregullat e përgjithshme të procedurës së likuidimit.

Në pikën 20 të nenit 99 të ligjit 66/2020 përcaktohet se “përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, dispozitat e legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare zbatohen lidhur me procedurat e likuidimit të detyrueshëm të shoqërive tregtare të themeluara në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe që janë subjekte të këtij ligji”.

Në nenin 100 të ligjit 66/2020 është parashikuar rendi i përmbushjes së pretendimeve në përputhje me nenin 605 të Kodit Civil. Në nëndarjet poshtë tij specifikohen kreditë e përcaktuara në radhën e parë të shlyerjes të paragrafit të parë të shkronjës “a” dhe shkronjës “e” të nenit 605.

Në paragrafin e dytë të nenit 100 parashikohet se “kur ka disa kredi sipas shkronjës “a” dhe shkronjës “e” të këtij neni, radha e preferimit përcaktohet sipas kritereve të përcaktuara me ligj të veçantë. Kur ligji i veçantë nuk i jep një kredie sipas shkronjës “a” preferim mbi kreditë sipas shkronjës “e”, kredia sipas shkronjës “a” do të preferohet sipas shkronjës “e”.

Pra, neni 100 i ligjit nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë” është në përputhje me radhën e preferimit të përcaktuar në neni 605 të Kodit Civil.

Për analogji, në ligjin nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”, në nenin 338, është përcaktuar i njëjti rend shlyerjeje për përmbushjen e pretendimeve me ligjin nr. 66/2020.



#### **IV. Përfundim.**

Në përfundim, Komisioni për Ekonominë dhe Financat thekson se:

*Së pari*, projektligji:

- është në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjore;
- është një përpjekje për të siguruar përputhje me direktivat e BE-së në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe direktivat për regjistrimin ose licencimin e të gjithë ofruesve të shërbimeve të mjeteve virtuale;
- është në përputhje me legjislacionin e brendshëm të vendit tonë;
- përbën një mekanizëm për zgjerimin dhe zhvillimin e tregjeve financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë në vendin tonë;
- pritet të japë impakt pozitiv në zgjerimin e biznesit inovativ, rritjen e investimeve dhe ekonominë e vendit.

*Së dyti*, është më mirë të kemi ligje dhe rregulla për veprimtarinë në tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë, se sa të lejohet që kjo veprimtari të zhvillohet pa mbikëqyrjen e shtetit.

*Së treti*, gjatë shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, si komision përgjegjës, është përpjekur të zgjerojë mundësinë e ndëshkimit për të gjitha veprimtaritë e jashtëligjshme që mund të ushtrohen në këtë treg.

Në përfundim, Komisioni e rrëzoi dekretin nr.11518, datë 22.06.2020, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë” me shumicë votash.

**RELATORI**

**Anastas ANGJELI**

**KRYETARJA**

**Milva EKONOMI**